

VENDIM
Nr. 189, datë 21.2.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË
BASHKËRENDIMIT TË INFORMACIONIT, NDËRMJET MINISTRISË SË
DREJTËSISË DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA, PËRGJEGJËSE PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR DËMSHPËRBLIM TË ISH-TË DËNUARVE
POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST, SI DHE TË LLOJIT TË PËRGJEGJËSISË
PËR ÇDO KËRKESË**

(Ndryshuar me VKM nr. 1296, datë 29.12.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 11 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjatë shqyrtimit të kërkesave për dëmshpërblim të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, Ministria e Drejtësisë bashkërendon punën me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Shërbimin Informativ të Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit dhe arkivat e sistemit gjyqësor.

2. Bashkërendimi i punës, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, kryhet për shqyrtimin e drejtpërdrejtë dhe shqyrtimin e bashkërenduar, për kërkesat për dëmshpërblim të subjekteve, kur plotësohen kriteret e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “d” të nenit 26 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”.

3. Shqyrtimi i drejtpërdrejtë:

i) Ministri i Drejtësisë, brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës nga ana e subjektit, në rastin e shkronjës “d” të nenit 26 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, ua përcjell kërkesën institucioneve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për verifikim të drejtpërdrejtë, në burimet arkivore të tyre, të periudhës 30.11.1944-1.10.1991.

ii) Institucionet e sipërpërmendura, brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës, përcjellin pranë Ministrit të Drejtësisë përgjigjen përkatëse, për plotësimin e kriterëve të nenit 4 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të shoqëruar me kopje të dokumenteve përkatëse arkivore.

iii) Përgjigjja e institucioneve është sipas tekstit në vijim:

“Pas verifikimit të drejtpërdrejtë, të kryer nga institucioni ynë, në bazë të shkronjës “d” të nenit 26 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, ju vëmë në dijeni se subjekti kërkues:

a) plotëson kriteret për të përfituar dëmshpërblim, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”;

ose

b) nuk plotëson asnjërën nga kriteret e parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist.

iv. Për shqyrtimin e drejtpërdrejtë të kërkesave të paraqitura nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, Ministri i Drejtësisë dhe institucionet e përmendura në pikën 1 veprojnë menjëherë, pavarësisht afateve të përcaktuara në nënndarjet “i” dhe “ii” të pikës 3.

4. Shqyrtimi i bashkërenduar:

i) Ministri i Drejtësisë, brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, për rastet e parashikuara në shkronjat “a” e “b” të nenit 26 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, ua përcjell institucioneve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, dosjen e kërkuarit, të shoqëruar me një shkresë përcjellëse, me anë të së cilës kërkohet verifikimi i kriterit të parashikuar në shkronjën “d” të nenit 4 të këtij ligji.

ii) Institucionet e mësipërme, brenda 30 ditëve nga depozitimi i dosjes, njoftojnë me shkrim, Ministrin e Drejtësisë dhe i përcjellin bashkëlidhur një kopje të dokumenteve përkatëse arkivore.

iii) Përgjigjja e institucioneve është sipas tekstit në vijim:

“Pas shqyrtimit të kryer në burimet arkivore të institucionit tonë, në bazë të nenit 27 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, ju vëmë në dijeni se subjekti kërkuar:

a) plotëson kriterin e parashikuar në shkronjën “d” të nenit 4 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”;

ose

b) nuk plotëson kriterin e parashikuar në shkronjën “d” të nenit 4 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist.

iv. *Për shqyrtimin e bashkërenduar të kërkesave të paraqitura nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, Ministri i Drejtësisë dhe institucionet e përmendura në pikën 1 veprojnë menjëherë, pavarësisht afateve të përcaktuara në nënndarjet “i” dhe “ii” të pikës 4.*

5. Procedura për bashkërendimin e punës, ndërmjet institucioneve përgjegjëse, sipas pikës 1 të këtij vendimi, zhvillohet sipas pikave të mësipërme edhe për shqyrtimin e denoncimeve të fakteve të pavërteta nga qytetarët, në përputhje me nenin 31 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”.

5/1. Ministri i Drejtësisë identifikon listën e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, të cilën ia përcjell Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Shërbimit Informativ të Shtetit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit.

5/2. Institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, lidhin memorandum bashkëpunimi ndërmjet tyre, për përshpejtimin e procedurave dhe të afateve të shqyrtimit të drejtpërdrejtë e të bashkërenduar të kërkesave të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, si dhe të komunikimit zyrtar ndërmjet tyre.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha